



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitave të nenit 18 të Ligjit nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal, nenit 6 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, të dt. 11.12.2012, dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.05.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NISMËN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

I.

MIRATOHET Vendimi për nismën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar.

II.

Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar do të zhvillohet me kryeqytetin e “Des Moines” IOWA-së.

III.

Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me Komunën si në pikën II të këtij vendimi, për përgatitjen e propozimmarrëveshjes për bashkëpunim ndërkombëtar.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0105388/18, më 04.05.2018



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta